



UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës

Nr. 02-54/15-07

Prishtinë, më 21 qershor 2007

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCES VERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Bislim Hoti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 71 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 13 majit, 1 dhe 4 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e kryeministrit, Ethem Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin dhe
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkokë, Grupi Parlamentar për Integrin ka parashtruar ndonjë mocion me shkrim për plotësimin e tij me pikën shtesë: “ Tejkalimi i kompetencave nga ana e Ekipit të Unitetit”.

Deputeti **Ferid Agani** e arsyetoi kërkesën e Grupit Parlamentar për Integrin.

**Kryetari** e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar për Integrin. Por, Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi kërkesën e këtij grupi.

Komisioni Parlamentar për Bujqësi dhe ai për Shëndetësi kishin kërkuar të hiqet nga rendi i ditës pika e tetë: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin.

**Kryetari** e hodhi në votim propozimin e këtyre komisioneve. Kuvendi me shumicë votash miratoi kërkesën e komisioneve për heqjen e pikës së tetë nga rendi i ditës.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese kishte kërkuar që Kuvendi në këtë seancë ta shqyrtojë edhe propozimin për ndryshimin e Rregullave të procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij.

**Kryetari** e hodhi në votim propozimin e Komisionit Legjislativ.

Kuvendi me shumicë votash miratoi kërkesën e këtij komisioni që rendit të ditës së kësaj seance t'i shtohet edhe pika: Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e Rregullave të procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij.

## 2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 31 majit, të 1 dhe 4 qershorit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 31 majit, të 1 dhe 4 qershorit 2007 u miratua me vërejtjen e deputetit **Fehmi Mujota**, që e kishte informuar Kuvendin për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore në komunën e **Shtimes**, kurse në procesverbal ishte evidencuar gabimisht “në komunën e Shtërpçës”.

## 3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i kishte parashtruar dy pyetje zëvendëskryeministrin të Kosovës, z. **Lutfi Haziri**, por ai nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me veprimet e kësaj ministrie për parandalimin e sëmundjes së rriqraive.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me formimin e Këshillit profesional për ndarjen e specializimeve për kuadrot shëndetësore.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Kollçaku.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale lidhur me ndihmën për organizatën HANDIKOS.

Ministri **Ibrahim Selmanaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Kollçaku.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me studimin e fizibilitetit për ndërtimin e rrugës Merdar – Morinë.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetes Shala.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me deponitë e automjeteve të vjetra përskaj magjistraleve.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi.

Deputeti **Jonuz Kastrati** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me veprimet e kësaj ministrie për parandalimin e sëmundjes së etheve hemorragjike në komunën e Malishevës.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kastrati.

Deputeti **Hydajet Hyseni** i kishte parashtruar pyetje Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Rendit lidhur me sjelljen e policëve ndaj të burgosurve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Ministri i Drejtësisë **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me veprimet e kësaj ministrie për dhëni e dokumenteve në komunën e Drenasit.

Ministri **Blerim Kuçi** tha se përgjigjen do ta përgatisë për seancën e radhës.

### **3. Interpelanca e ministrit, Ethem Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së**

**Kryetari** i informoi deputetët për procedimin e kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së dhe për përgjigjen e ministrit, si dhe për kohëzgjatjen e debatit.

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e micionit ta marrë fjalën.

**Jakup Krasniqi**, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së tha se resurset natyrore të Kosovës dhe prona publike janë duke u keq-menaxhuar, duke u degraduar dhe duke u tjetërsuar në dëm të ekonomisë së Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Shembulli më tipik i veprimeve të tilla është dhënia e licencës “Kompanisë Kosova Resurs LLC” nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Për hulumtimin e mineraleve në Çukën e Batllavës (Drazhnjës) kjo licencë hulumtimi është dhënë në mënyrë të padrejtë për shumë arsyesh: KPMM-ja ia ka dhënë licencën për hulumtim një kompanie të huaj për ta hulumtuar në pasurinë e Trepçës pa e pyetur atë fare edhe pse kjo është pronë e Trepçës, ku janë kryer hulumtimet më se dy dekada dhe e ka përgatitur minierën për shfrytëzim; licenca është lëshuar pa procedurë tenderimi; në kohën kur i është dhënë licenca kompanisë “Kosova Resurs LLC” Aleksandër Valenta ishte anëtar

i KPM-së, i cili pastaj është punësuar pona këtë kompani dhe kjo tregon se ka pasur konflikt të interesit; nuk ka pasur transparencë gjatë dhënies së licencës.

**Kryetari** e ftoi ministrin Ethem Çeku ta marrë fjalën.

**Ministri Ethem Çeku** – Ne, si Ministri, nuk kemi pasur informacion zyrtar dhe nuk kemi mundur ta pengojmë dhënien e kësaj licence. Kemi kërkuar nga PSSP-së, zëvendësi i PSPP-së - Shtyllës së katërt, AKM-së që të diskutohet dhënia e licencës asaj kompanie se a është dhënë në pajtim me Rregulloren nr. 2005/3, që është në fuqi.

Gjatë analizave, që i kemi bërë, gjemjë se ka pas shkelje të kësaj rregulloreje dhe shkelja vjen sipas nenit 61 paragrafët 1 dhe 2 në bazë të të cilëve Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve është obliguar që ta hartojë planin për menaxhimin e resurseve minerale dhe një plan të tillë duhet t'i dorëzohet MEMI-t për shqyrtim, miratim dhe shpallje. Një obligim i tillë nuk është kryer nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve.

Ne, në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar, kemi kërkuar të ndërpritet dhënia e çfarë do licence për resurse minerale të rëndësishme apo vitale për zhvillimin ekonomik të vendit, posaçërisht të plumbit zinkut, arit, argjendit dhe mineraleve të tjera deri sa Ligji të hyjë në fuqi dhe të miratohet strategjia e minierave.

Ne kemi marrë një konfirmim nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve që e pezullon dhënien e çdo licence me resurse të interesit jetik për zhvillimin ekonomik të Kosovës për 6 muajt e ardhshëm.

Përpos problemit të Drazhnjës, kemi edhe probleme të tjera që kanë të bëjnë me Trepçën, prandaj ne tanë jemi në përfundim të strategjisë për këtë fushë. Kërkojmë të shpallet Ligji për Miniera dhe ta bëjmë një platformë të përbashkët për gjetjen e një konsensusi se si do të ecim në fushën e minierave metalike, posaçërisht minierave që janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Pas fjalës së ministrit Çeku, **kryetari** e hapi debatin.

Në emër të grupeve parlamentare diskutuan: **Ibush Jonuzi** në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Ilmi Ahmeti, Hatixhe Hoxha, Xhevdet Neziraj, Sala Berisha-Shala, Bajrush Xhemajli, Naim Maloku, Alush Gashi, Sabri Hamiti, Behxhet Brajshori** dhe **Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, në emër të parashtruesit të mocionit, **Jakup Krasniqi** kërkoi që Kuvendi t'i miratojë këto

## RE KOMANDIME

1. Kuvendi i Kosovës kërkon nga PSSP-ja që ta pezullojë dhënien e licencës për hulumtime kompanisë “Kosovo Resorce Compani” nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.
2. PSSP-ja ta shpallë Ligjin për minierat dhe mineralet.

**Kryetari** kërkoi deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare për motionin e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kryetarët e grupeve parlamentare u deklaruan se Kuvendi duhet ta autorizojë Komisionin Funksional, që në bazë të debatit të zhvilluar në Interpelancën e ministrit Ethem Çeku lidhur me dhënien e Licencës për hulumtime kompanisë “Kosovo Resorce Company” nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe në konsultim me grupet parlamentare, t'i hartojë rekomandimet dhe Kuvendit t'ia paraqesë për miratim në seancën radhës.

**Kryetari** e hodhi në votim këtë propozim. Kuvendi me shumicë votash e miratoi propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të cekur më lart.

**Kryetari** dha pauzë për drekë.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë**

**Kryetari** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligji para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Shëndetësisë, z. **Sadik Idriz**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Idrizi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Idrizi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Naim Jerliu**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bajram Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, Fatmire Muhaxha – Kollçaku, në emër të Grupit Parlamentar për Integrin, **Ferid Agani** dhe emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, si dhe deputetët: **Fehmi Vula**, **Zahrije Jusufi**, **Nekibe Kelmendi** dhe **Mark Krasniqi**, që i janë bashkangjitur trasnkriptitit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 59;  
Kundër----- 1;

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për barnat narkotike, për substancat psikotrope dhe prekursorë.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

## 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punëve të Brendshme, z. **Blerim Kuçi**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Kuçi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Kuçi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Emin Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Ylber Hysa**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrin, **Ferid Agani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Fadil Geci** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Husnija Beshkoviq**, si dhe deputetët: **Qibrije Hoxha, Agim Krasniqi, Nuran Malta, Fetah Berisha, Nekibe Kelmendi, Hydajet Hyseni dhe Nazim Jashari**, që janë bashkangjitur trasnkriptitit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 63;  
Kundër----- 1;

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për dokumentet e udhëtimit.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Siguri - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoit **Bislim Hoti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

## 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e ndihmës sociale

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punës është i Mirëqenies Sociale, z. **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit skemën e ndihmës sociale.

Në vazhdim ministri **Selmanaj** i shpjegoi materien, objektivat e Projektligjit dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Selmanaj**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nafije Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK- **Zahrije Jusufi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të grupit Parlamentar të ORA-s, **Fatmire Mulhaxha Kollçaku**, në emër të grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**, në emër të Grupit parlamentar 6 Plus, **Shpresa Murati**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, si dhe deputeti **Nazim Jashari**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----52;  
Kundër----- 7;  
Abstenime-----1.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara**

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, **z. Ibrahim Selmanaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministri **Selmanaj** i shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Selmanaj**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Ilaz Pireva**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK- **Zahrije Jusufi**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të grupit Parlamentar të ORA-s, **Fatmire Mulhaxha Kollçaku**, në emër të grupit Parlamentar për Integrim, **Ferid Agani**, në emër të Grupit parlamentar 6 Plus, **Shpresa Murati**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Milazim Haliti**, si dhe deputetët: **Gjylishtene Berisha**, **Nafije Berisha**, **Naxhije Doçi**, **Hajredin Hyseni** dhe **Ramadan Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----61;  
Kundër----- 0.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin**

Me kërkesë të Komisionit për Shëndetësi dhe të atij për Bujqësi u hoq nga rendi i ditës Projektligji për ushqimin me arsyetim se këto komisione duhet t'i harmonizojnë qëndrimet rreth amendamenteve të propozuara.

### **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim**

**Kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funksional lidhur me këtë projektligj.

Komisioni për Buxhet dhe Financa – Komision Raportues – kishte rekomanduar që Kuvendi ta miratojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim në formën e propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;  
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe për riorganizimin e personave juridikë.

### **10. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e Rregullave të procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij**

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ta arsyetonte këtë propozim.

**Hydajet Hyseni**, kryetari i Komisionit - shpjegoi në hollësi ndryshimet e propozuara të Rregullave procedurale për emërimin e Avokatit të Popullit për t'i harmonizuar ato me Rregulloren e UNMIK nr. 2007/15.

Kryetari i hodhi në votim propozimet e komisionit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----49;  
Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi propozimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullave procedurale për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij.

**Kryetari** e deklroi seancën të mbyllur në orën 17: 45 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoit

**Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**